



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LENDËS
Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: HISTORI E ARTI

Pedagogu: Phd.c. Edlira Çaushti
Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)
Programi i studimit: bachelor
Viti/Semestri: II/II

EKSTRAKT

Ky cikël leksionesh ka për qëllim të njohë studentet me fillsat e formave të para të shprehjes qysh prej periudhave prehistorike duke bërë një panoramë të gjerë të artit të shpellave e duke vijuar me menyra dhe materiale të tjera shprehjes. Leksionet mbi artin në periudhat arkaike, klasike dhe helenistike do të beje të mundur njohjen e metejshme të formave dhe shprehjeve, bazuar edhe në materialet e realizimit të tyre. Periudha romake dhe pasqyrimi i saj në ndërtimet arkitekturore do të pasohet prej artit në periudhën paleokristiane, që një vend të rëndësishëm do të zërë arti i mozaikut dhe realizimi i tij në kontekste të ngrehinave të kultit. Vend të rëndësishëm do të zërë arti bizantin dhe pasbizantin. Format e shprehjes së tyre dhe ndikimi i tyre në vend. Pikturat murale në teknikën e afreskut, ikonat dhe ikonostaset, larmishmeria e tyre dhe materialet e perdorura, do të plotesojnë një cikël të rëndësishëm leksionesh për lëndën. Tjetër temë e rëndësishme, do të jetë në lidhje me artin e aplikuar në monumente të kultit islam, zhvillimi i tij dhe influencat që pati prej artit të orientit. Zbukurimi i banesave me pikturat murale si dhe dekorime ornamentike do të pasohet me leksionet e fundit që do të paraqesin zhvillimin e artit në Shqipëri në shekujt XIX dhe XX.

TEMAT:

LEKSION 1. Arti në prehistori (pikturat e shpellave si forma të para të shprehjes)

LEKSION 2. Arti i aplikuar nëpërmjet figurinave gjeometrike e atyre të pikturuara. Figurinat antropomorfe dhe zoomorfe dhe përhapja e tyre në territor.

LEKSION 3. Arti në periudhën arkaike, klasike dhe helenistike. Vepra në gur dhe mermer : Skulptura e rrumbullakët, relieve dhe objekte funerare.

LEKSION 4. Arti në periudhën arkaike, klasike dhe helenistike. Qeramika, qelqi dhe metalet, teknikat dhe përdorimi i tyre.

LEKSION 5. Periudha Romake dhe forma të shprehjeve artistike. Pikturat murale, elementet dekorativë të arkitekturës dhe mozaiket.

LEKSION 6. Periudha e hershme kristiane dhe arti i aplikuar (elemente arkitekturorë, mozaikët pavimentalë)

LEKSION 7. Piktura murale bizantine në monumentet e Shqipërisë në kontekstin e artit bizantin. Shkëlqimi i pikturës dhe autore të njohur.

LEKSION 8. Ikonat bizantine dhe autore të njohur.

LEKSION 9. Miniaturat dhe doreshkrimet, dhe arti i aplikuar në to.

LEKSION 10. Larmia e shprehjes së artit post bizantin, piktura murale, elementet dekorative si dhe ikonabartësit në brendësi të ndërtimeve të kultit të krishterë.

LEKSION 11. Arti i aplikuar në brendësi të monumenteve të kultit islam, shprehje të tij në pikturë, dekorime të drunjtë si dhe materiale të tjera. Teknika.

LEKSION 12. Arti i aplikuar në banesat tradicionale, pikturat murale dhe elemente të tjera të realizuara në dru, gurë e stuko.

LEKSION 13. Tipare të përgjithshme dhe arti i aplikuar popullor.

LEKSION 14. Arti i rilindjes kombëtare dhe i periudhës së pavarësisë.

LEKSION 15. Arti në periudhën e pas Luftës në Shqipëri. Arti i Realizmit socialist dhe monumentet e qyteteve.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. Korkuti, Myzafer : Arti shkëmbor në Shqipëri, Tirane.
2. Hudhri Ferid, Albania through art, Tirane 2008
3. Douglas, Bailey , The figures of old Europe. San Francisco State University.
4. Dhamo, Dhorka, konsiderata mbi zhvillimin e mozaikut paleokristian ne shqiperi. Iliria, 1986.
5. Buschahausen, Helmut - Chotzakoglou, Chary. Piktura shqiptare në artin bizantin dhe pasbizantin, *Monumentet*, 2003, fq. 97 – 125.
6. Puzanova, Viktori. Arti shqiptar i shek. XVIII. Bulletin per shkencat shoqerore. Tirane 1957
7. Shkupi, Fatbardha, Artet e aplikuara ne banesen shkodrane. « Mjeshtrit dhe arkitektura popullore » Tirane 1976
8. Tipare te zburimores nga shek. XVII deri ne fillim te shek. XX ne Shqiperi. *Monumentet*, Tirane 1988/2.
9. Velo Maks, Dekori i thjeshte linear ne gur. *Monumentet*, Tirane 2002.

10. Popa Theofan, Disa konsiderata te pergjithshme te piktures postbizantine ne Shqiperi. Studime historike 1967. Tirane.